



Lajmëtari i Radio Marisë

Korrik 2011

Viti III, Nr. 7

Në këtë numër do të lexoni

- Lajmëtari i Radio Marisë troket në derën tënde 2
- Festa e Radio Marisë në Laç të Vaut të Dejës 2
- I Lumi Papa Gjon Pali II dhe Virgjëra Mari (pj. 2) 3
- Fëmija, dhuratë e Zotit 4

Lajmëtari i Radio Marisë është organ i Shoqatës Radio Maria.

Tiranë

Rr. Papa Gjon Pali II, Nr. 4
Fushë Kërçik
Babrru, Paskuqan
Tiranë, Shqipëri
+355 4 2 346 346

Shkodër

Sheshi Papa Gjon Pali II
Shkodër, Shqipëri
+355 22 24 08 52

E-mail

info@alb.radiomaria.org

Përgjegjës

Don Prekë Lazraj

Radio Maria,
Hiri i Hyjit në shtëpinë tënde,
mund të dëgjohet në:

Prëshen e rrethina
FM 100.7 MHz

Tiranë, Durrës, Kavajë, Berat
FM 91.4 MHz

Shkodër, Podgoricë, Ulqin
FM 102.2 MHz

Lezhë, Laç të Kurbinit, Mamurras
FM 89.6 MHz;

Pukë, Fushë Arrëz, Tropojë,
Kukës dhe Kosovë

FM 90.0 MHz

www.radiomaria.al

MUAJI KORRIK, MUAJI I RADIO MARISË



Të dashur miq dhe dëgjues të Radio Marisë, për të gjithë ne, korriku është muaji i Radio Marisë. Nëna jonë qiellore e zgjodhi këtë muaj të pushimeve për ta bashkuar në njësi popullin me Nënë, e cila do që secilën ditë të na afrojë te Biri i saj, Jezusi, dhe në këtë mënyrë të na aftësojë që të afrohem edhe me njëri-tjetrin. Ky bashkim është më se i vërtetë, sepse në këtë muaj kemi lënë vendet e punës që të kthehem aty ku peshojmë më rëndë, aty ku trupi dhe shpirti e gjejnë prehjen e nevojshme, në vendin që si vendlindje na dhuroi Nëna jonë qiellore.

Bashkimin mes bijve dhe bijave, Nënës dhe Jezusit, nuk mund ta bëjë askush më mirë se sa Krijesa më e bukur, krijesa që ia këndoi këngën më të bukur Hyjit të jetës, ajo që na përcjell përmes zërit të Radio Marisë duke na ftuar që ta zbulojmë jetën, lutjen dhe virtytet e saj e për t'i zbatuar ato gradualisht çdo ditë në jetën tonë. Gjëja më e bukur që mund ta jetojmë gjatë këtij muaji është që ta zbulojmë Rruzaren, lutjen e Marisë, dhe që të lutemi me të e si ajo.

Maria na frymëzon lutjen e Rruzares së shenjtë, lutjen kryesore të familjeve tona në kohërat e shkuara dhe në kohën e tashme, lutjen me të cilën besimtarët e vërtetë e fillojnë dhe e mbarojnë ditën e tyre. Këtë lutje të familjeve tona,

në kohërat e fundit e ka përjashtuar armiku i saj, televizori, dhe së bashku me të e ka përjashtuar gëzimin, kuptimin, bisedën, pjesëmarrjen tonë në jetën e Hyjit së bashku me Nënë. Që ta lusim mirë Rruzaren, kemi nevojë që t'i krijojmë kushtet, ta krijojmë atmosferën e lutjes së saj. Lutja nuk bëhet vetvetiu, ajo e ka vendin dhe atmosferën e nevojshme. Kur në familje, në zemrën e secilit anëtar të saj mbretëron atmosfera e fesë, e kemi shumë të lehtë që t'i krijojmë kushtet dhe atmosferën për ta lutur Rruzaren. Maria, para së gjithash, kërkon që fëmijët e saj të jenë të bashkuar, të rrinë së bashku në të njëjtin vend, ta ndiejmë veten të bashkuar në brendi, fëmijë që kënaqemi që jemi me njëri-tjetrin, që jemi në familje, sepse vetëm si familje e bashkuar kemi mundësi ta lusim Rruzaren në mënyrë të mrekullueshme dhe të frytshme. Duke u lutur kështu para Nënës, zbukurohet jeta e atyre që luten së bashku. Vetëm duke u lutur së bashku, do ta ndiejmë se jemi familje që i përket Hyjit, ndiejmë se jemi një qenie e vetme, të bashkuar në misterin e Jezu Krishtit, i cili është i pranishëm në secilin anëtar të kësaj shtëpie që gjatë Rruzares bashkohet me të tjerët në emrin e Tij.

Shën Luka na tregon çastin kur lindi dashuria ndaj Marisë në zemrën e njeriut dhe kush është burimi dhe shkaktari i kësaj dashurie. Ai thotë se dashuria ndaj Marisë lindi që nga çasti kur Hyji e dërgoi në tokë Gabrielin Kryeengjëll në një qytet të Galileesë, në Nazaret, te Virgjëra që quhej Mari.

Këtu, të dashur miq të Radio Marisë, na paraqitet veprimi i Hyjit. Ai e dërgon Gabrielin Kryeengjëll. Hyji e zgjodhi Marinë dhe trokiti në zemrën e saj. Maria i hapë dyert e zemrës së saj plotësisht përpara Hyjit duke u bërë në atë çast bashkëpunëtorja më e madhe e shëlbimit të të gjithë njerëzve. Nëna që në të gjitha kohërat e Kishës i bashkon bijtë dhe bijat për t'i këshilluar që të bëjnë çfarë thotë Jezusi. Ajo në atë çast e pranon Jezusin dhe do të mbetet pranë Tij përgjithmonë.

Hyji e zgjodhi Marinë që të vijë edhe te ti përmes valëve të Radio Marisë, për të të kthyer te vetja jote, familja jote, grua jote, burri yt, fëmijët e tu, prindërit, gjyshërit, miqtë e tu... Hyji e zgjodhi Marinë që të të sjellë përsëri te besimi dhe dashuria e vërtetë e zemrës sate. Hyji e zgjodhi Marinë që të mos ndahet më prej teje, sikurse është e pandashme nga Jezusi, Biri i saj.

Bëftë Hyji që t'i afrosh Marisë dhe, bashkë me të, asaj dashurie që e kërkon zemra jote!

Don Preka

«LAJMËTARI I RADIO MARISË» TROKET NË DERËN TËNDE

Të dashur lexues,

së bashku me Radio Marinë Shqiptare ka kohë që ne kemi edhe gazetën «Lajmëtari i Radio Marisë». Ky numër që ju po shfletoni është nr. 30 i kësaj gazete. Që nga janari i vitit 2009, ajo ka pasqyruar muaj pas muaji jetën e Radio Marisë Shqiptare. Krahas programeve të radios, edhe kjo gazetë është bërë pjesë e pandarë e dëgjuesit, ku në fletët e saj marrin informacione, meditime, lutje, ftesa, etj.

Që në muajt e parë të këtij viti, shpërndarja e saj ka marrë një formë tjetër që na ka lidhur edhe më shumë me dëgjuesit dhe bashkëpunëtorët e radios kudo. Me ndihmën e Hyjit dhe nga dashuria e gatishmëria e bashkëpunëtorëve të radios, në shumë fshatra është arritur që gazeta «Lajmëtari i Radio Marisë» të trokasë në derën e çdo bamirësi, në shenjë falënderimi ndaj tyre. Kjo gjë ka sjellë edhe rritjen e numrit të bashkëpunëtorëve të radios në këto fshatra, sepse një apo dy veta e kanë shumë të vështirë ta shpërndajnë gazetën në të gjithë fshatin, sidomos në ato me sipërfaqe dhe popullsi të madhe. Prandaj, thirrjes së bashkëpunëtorëve për ndihmë në shpërndarjen e gazetës iu janë përgjigjur edhe dëgjues të tjerë, të cilët kanë filluar ta shpërndajnë gazetën në lagjet e tyre. Kjo e ka rritur edhe më shumë kontaktin personal me dëgjuesin, të cilët edhe në këtë rast, si për të gjitha huret që Hyji sjell në jetët e tyre, e falënderojnë Radio Marinë.

Po ju përcjell fjalët që Gjergji, një dëgjues dhe bamirës i radios nga Trushi, na i tha kur ishim për transmetimin e Meshës, në datën 22 maj 2011.

«Jam Gjergji dhe e kam ndjerë veten shumë i vlerësuar, unë dhe familja ime, kur Nushi (bashkëpunëtor i radios) më solli gazetën «Lajmëtari i Radio Marisë». Kjo gjë tregoi se Radio Maria është një familje e madhe që nuk ka kufi në dashuri».

E falënderojmë Hyjin që tashmë kemi arritur që në shumë fshatra ta çojmë gazetën në dorën e çdo bamirësi të radios. Por, ne kemi edhe shumë fshatra e qytete ku, për arsye të adresave dhe mungesës së bashkëpunëtorëve, nuk kemi arritur ta mundësojmë trokitjen e gazetës «Lajmëtari i Radio Marisë» në derën e bamirësve. Prandaj, ju ftoj të gjithëve ju, që mund ta kryeni këtë shërbim, që të vini e të bëheni bashkëpunëtorë të kësaj nisme që sjell gëzim në çdo derë ku troket. Ejani të udhëtojmë së bashku në rrugën, në të cilën na thirri Hyji.

Roza

FESTA E RADIO MARISË NË LAÇ TË VAUT TË DEJËS



Në datën 25 qershor 2011, u festua festa e Radio Marisë Shqiptare me besimtarët, dëgjuesit dhe bashkëpunëtorët e radios në Dioqezën e Sapës. Kjo festë u zhvillua në një atmosferë shumë të ngrohtë në Katedralen e së Lumes Nënë Tereza, në Laç të Vaut të Dejës.

Besimtarë të shumtë e kishin mbushur Katedralen. Dita nisi fillimisht me adhurimin e të Shenjtërueshimit Sakramet, ku të gjithë e bëmë përvojën e takimit tonë intim me Jezusin Eukaristi. E falënderuam Jezusin për të gjitha të mirat shpirtërore që i ka sjellë në jetët e secilit prej nesh përmes valëve të Radio Marisë dhe që qëndron gjithmonë afër nesh në të gjitha nevojat tona të përditshme.

Pastaj e lutëm Kurorën e Arit në nder të përgatitjes për të kremten e Zembrës së Krishtit. Familja e Radio Marisë Shqiptare e ka bërë përshpirtërinë e Zembrës së Krishtit gjatë gjithë muajit qershor, muajit kushtuar Zembrës Tejet të Shenjtë të Jezusit, të cilës ia kushtuam secilin anëtar të familjeve tona.

Festa kulmoi me kremtimin e Meshës së shenjtë, të cilën e kremtoi Don Simon Kulli, famullitari i Katedrales bashkë me Don Prekë Lazrajn, drejtorin e Radio Marisë Shqiptare.

Pas Meshës, Don Preka mbajti një takim me dëgjuesit e radios që ishin aty të pranishëm. Ai i njohu ata me zhvillimet më të fundit në radio, me nismat e ndërmarra dhe foli mbi rëndësinë e bashkëpunimit dhe të ndihmës që të gjithë duhet ta japin për radion. Takimi u prit me shumë interes dhe u shkëmbyen mendime për vazhdimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Ky takim u zhvillua në kuadrin e vitit të provmovimit të Radio Marisë.



Orselina

I LUMI PAPA GJON PALI II DHE VIRGJËRA MARI

Ky është një shkrim i punuar nga Imzot Juan Miguel Ferrer Grenesche, Nënsekratr i kongregatës për kultin Hyjnor dhe disiplinën e sakramenteve, të cilin do ta sjellim me pjesë në disa numra të Lajmëtarit.

...vazhdon nga numri i kaluar

Secili angazhim, secili veprim që përpiqet të realizojë misionin e Kishës, secili aktualizim i planeve baritore duhet të nxjerrë forcën e nevojshme nga Misteri Eukaristik dhe duhet të na tërheqë drejt saj si drejt pikës më të lartë. Në Eukaristi e kemi Jezusin, e kemi flijimin e Tij shëlbimprurës, e kemi ngjalljen e Tij, e kemi dhuratën e Shpirtit Shenjt, e kemi adhurimin, bindjen dhe dashurinë e Atit. Po ta linim pasdore Eukaristinë, si do ta zëvendësojmë mungesën tonë? (nr. 60). Papa vazhdon: «Nuk ka rrezik që ta teprojmë duke u kujdesur për këtë Mister, sepse «në këtë Sakrament përmbledhet krejt misteri i shëlbimit tonë» (nr. 61). Për të përfunduar: «Të vendosemi, vëllezër e motra, në shkollën e shenjtë, interpretuesve të mëdhenj të përshpirtërisë së vërtetë eukaristike. Në to, teologjia e Eukaristisë e merr krejt shkëlqimin e të jetuarit, («kalon tek ne, të themi ashtu, na 'ngroh'»). Të vendosemi mbi të gjitha në dëgjim të Virgjërës Mari, në të cilën Misteri Eukaristik paraqitet, më shumë se në çdo gjë tjetër, si mister i dritës. Duke shikuar në të e njohim forcën shndërruese që e ka në vetvete Eukaristia» (nr. 62).

Forma e kushtimit monfortian "Totus tuus", më pas na zbulon çelësin e përshpirtërisë, dhe në pjesën më të madhe, Magjisterin të tashëm pothuajse të të Lumit Gjonit Palit II. Mirëpo për të përplotësuar këtë mënyrë të krishterë të të qenurit dishepull dhe të njëjtësimin me Jezu Krishtin në ecjen dhe «në shkollën e Marisë» (që ushtron në këtë mënyrë ndërmjetësimin amnor mbi ne), është e nevojshme të lexojmë veprën tjetër të njohur të Shën Ludovik Maria de Monfortit: "Sekreti i admirueshëm i Rruzares së Shenjtë". Në letrën e vet apostolike "Rosarium Virginis Mariae" (16 tetor 2002: një ditë tepër domethënëse për të, përsëri sa i përgjigjet fillimit 25-vjetorit të pontifikatit të tij), Gjoni Pali II e paraqet vizionin e vet personal dhe marrjen e atij elementi themelor të kësaj shkolle shpirtërore, në të cilën gjenden çelësat e leximit të jetës së tij të fesë. Ta lexojmë pikën e parë të kësaj letre:

«Rruzarja, në të vërtetë, edhe pse karakterizohet nga fizionomia e vet mariane, është lutje që del nga zemra kristologjike. Në qartësinë e elementeve të veta, përqëndron në vetvete thellësinë e porosisë ungjillore, sepse paraqitet pothuajse si përmbledhje e tyre. Në të jehon lutja e Marisë, Shpirti im e madhëron Zotin, në mënyrë të amshueshme për veprën e Mishërimit shëlbimprurës që dalloj në kraharorin virgjëror. Me të, populli i krishterë vendoset në shkollën e Marisë, për të lejuar që ajo ta udhëheqë në soditje të bukurisë së fytyrës së Krishtit dhe të përvojës së thellësisë së dashurisë së Tij. Përmes Rruzares, besimtari thith plotësinë e hirit, pothuajse duke e marrë përsëri nga duart e Nënës së Shëlbuesit».

Këto bindje e sollën Gjonin Palin II për ta shpallur atë vit, nga tetori 2002 deri në tetor 2003, Vit të Rruzares (letra apostolike "Rosarium Virginis Mariae", pika nr. 3). Në pikën 7 të kësaj letre, Papa e sqaroi lidhjen e kësaj lutjeje me ushtrimin misionit të Marisë dhe tha: «Shumë shenja tregojnë atë që Virgjëra e shenjtë edhe sot e kësaj dite e ushtron, pikërisht përmes kësaj lutjeje, kujdesin amnor që Shëlbuesi, duke vdekur ia besoi në personin e dishepullit të dashur, të gjithë bijtë e Kishës: «Grua, ja yt bir!» (Gjn 19, 26). Janë të njohura rrethanat e ndryshme, në shek. XIX dhe XX, në të cilat Nëna e Krishtit ka bërë në njëfarë mënyre të ndjehet prania dhe zëri i saj për ta nxitur popullin e Hyjit në këtë formë të lutjes kontemplative. Dëshiroj në mënyrë të veçantë të kujtoj ndikimin mbresëlënës në jetën e të krishterëve për njohjen që u bëri autoriteti kishtar dukjeve të Zojës në Lurd dhe Fatima, në të cilat shenjtëoret janë bërë qëllim i shtegtimeve të shumta të besimtarëve që kërkojnë ndihmë dhe shpresë».

Në të njëjtën letër apostolike, Papa paraqiti si një soditje të Krishtit, në krejt Misterin e tij, me Marinë, personin më të bashkuar me të (kapitulli 1, pikat nr. 9-17), derisa nuk e njëjtëson në Krishtin duke u bërë si ajo (pika nr. 15 në të cilën shpjegon moton e vetë "Totus tuus"). Përveç kësaj, Rruzarja është përmbledhje e Ungjillit (pika nr. 18). Me pikën nr. 18, fillon kapitulli II i letrës, në të cilën Ati i shenjtë i shpjegoi arsyet e vendosjes së mistereve të reja në traditën e gjatë të Rruzares, të cilat ai i pagëzoi si («të dritës») (pika nr. 21). I pesti në mesin e këtyre mistereve të reja do të jetë themelimi i Eukaristisë me të cilën ai e paraqiti lidhjen e vërtetë të përshpirtërisë së vet, mes Eukaristisë dhe Marisë (fundi i pikës nr. 21; të shikohet enciklika "Ecclesia de Eucharistia" pika nr. 53, përgjithësisht, krejt kapitulli 6 i të njëjtës enciklikë, pika nr. 53-58).

Rruzarja ishte për Gjonin Palin II lutja e zgjedhur që bashkon me Krishtin përmes Marisë, dhe përmes Krishtit tregon planin e Hyjit përballë krejt gjinisë njerëzore, duke promovuar misionin e Kishës dhe të secilit të krishterë. Në këtë kuptim, del thelbësor pika nr. 25 e letrës mbi Rruzaren, të cilën Papa e fillon duke thënë: «Në dëshminë tashmë të kujtuar të vitit 1978 mbi Rruzaren, që është lutja ime e zgjedhur, paraqita konceptin të cilit dëshiroj t'i rikthehem. Atëherë thashë se («lutja e thjeshtë e Rruzares tregon ritmin e jetës njerëzore») (Engjëlli i Hyjit, 29 tetor 1978: Insegnamenti I (1978), 76). Kush vendoset në soditje të Krishtit, duke kaluar nëpër etapat e jetës së Tij, nuk ka mundësi të mos marrë në Të edhe të vërtetën për njeriun». Më pas, e kujtoi programin e vet, që është i pranishëm që nga fillimi i pontifikatit, në enciklikën e tij "Redemptor Hominis".

Në të vërtetë, Rruzarja bën që të identifikohemi kishtarisht me Krishtin dhe me misionin e tij, dhe kjo gjë bëhet e dukshme në mënyrë të veçantë në kapitullin 3 të kësaj letre (pika nr. 26-38). Misioni i Krishtit plotësohet sot në angazhimin e përcaktuar për të ndërtuar paqen; Rruzarja është e orientuar drejt paqes (pika nr. 40); në luftë për të mbrojtur familjen si element themelor të shoqërisë dhe të Kishës; Rruzarja është lutje e familjes dhe për familjen (pika nr. 41); dhe është një lutje që thuhet për të shoqëruar procesin e rritjes së fëmijëve në gjirin familjar, përderisa Rruzarja është lutje e bijve dhe për bijtë (pika nr. 42). Prapëseprapë, Gjoni Pali II ftoi jo vetëm për ta lutur këtë lutje të rekomanduar, por edhe për ta bërë secilën herë më mirë. Na ftoi që ta rijetojmë Rruzaren në një mënyrë intensive dhe kontemplative si tradita më e shëndoshë e krishterë që largon rrezikun e përfundimit në kërkimin lëmshë të besimit e tjera dhe praktikat medituese, ndonjëherë pozitive dhe në përputhje me përvojën e krishterë, por herëve të tjera me një prapaskenë ideologjike të papranueshme (pika nr. 28). Në këtë pikëpamje, Papa ofroi disa sugjerime rreth mënyrës se si ta lusim Rruzaren (pikat nr. 29-38): këto iu përkasin shpalljes së mistereve, pranisë së Fjalës së Hyjit, kujdesit për të ruajtur heshtjen, mënyrës së lutjes së lutjeve Ati ynë, Të falemj Mari, Lavdi Atit dhe të vendoset mënyra e përfundimit. Pa harruar vlerën që vendosi në shenjë e Rruzares dhe konsideratën e mënyrave të ndryshme për ta filluar dhe përfunduar këtë lutje duke ritmuar kohën gjatë gjithë kohës që ajo zgjat.

...vazhdon në numrin tjetër.

FËMIJA, DHURATË E ZOTIT

Jo spirales! - Jo pilulës! - Jo prezervativit! - Jo sterilizimit! - Jo ngjizjes artificiale! - Jo mëkatit!

* Spiralja e shndërron gruan e shëndetshme në të sëmurë, pasi ajo shkakton qelbëzim në mitër, në tubat e fallopit të mitrës, në vezore dhe në krejt hapësirën e barkut, gjakderdhje, dhimbje dhe anemi. Spiralja e vret fëmijën! Pas kryerjes së marrëdhënieve seksuale mund të kemi një ngjizje. Por, kur fëmija shkon në mitër dhe dëshiron të kapet e të ngulet në muret e saj, nuk arrin ta bëjë këtë gjë, sepse e pengon spiralja.

* Ka disa lloje pilulash kundër shtatëzanisë, të cilat edhe pse merren, prapëseprapë gruaja arrin deri në ovulim dhe mund të kemi edhe ngjizje të fëmijës. Por, fëmija në këto raste vdes nga uria, sepse pilula shkakton mungesën e glikogenit në mukozën e mitrës. Si rrjedhojë, ajo thahet dhe nuk e ushqen fëmijën. Mungesa e menstruacioneve na tregon se fëmija është i pranishëm, domethënë jeton dhe për këtë nuk guxon të vritet assesi. Gratë që përdorin pilula kundër ngjizjes vuajnë shumë nga kanceri i gjirit, i lëkurës dhe nga ai i mitrës. Ato janë të pritura për të pasur infarkt të trurit dhe të zemrës, varriçe, të cilat mund të shkaktojnë edhe emboli, dëmtim të mëlçisë dhe të nervit të syrit, ulje të imunitetit, etj. Pilulat kundër shtatëzanisë nuk janë zgjidhje për rregullimin e ciklit jo të rregullt të menstruacioneve.

* Edhe me përdorimin e mjeteve të tjera të ashtuquajtura kontrceptive, domethënë kundër ngjizjes, arrihet deri te ngjizja, por vrasja e fëmijës bëhet në mënyrë automatike që në ditët e para. Jezusi ka thënë "Për të vërtetë po ju them, çkado bëtë për njërin ndër këta vëllezër të mi më të vegjël, e bëtë për mua" (Mt 25, 40). Ai fëmijë i vogël, është vëllai ynë më i vogël dhe motra jonë më e vogël, pasi jeta e njeriut fillon që në momentin e ngjizjes. Çfarëdolloj problemesh që mund të kesh, nuk guxon ta vrasësh. Në qoftë se ke probleme e të nevojitet ndihmë, lirisht paraqitu pranë ndonjë meshtari, motre apo "Lëvizjes për jetën". Duhet të kemi besim në Zotin. Krishti na mëson: "Mos u brengosni, prandaj duke thënë: 'Çka do të hamë?' e 'Çka do të pimë?', 'Me çka do të vishemi?' - këto gjëra i kërkojnë paganët - sepse Ati juaj qiellor e di mirë se ju keni nevojë për të gjitha këto. Kërkoni, pra, më së pari Mbretërinë dhe drejtësinë e tij e të gjitha këto do t'ju jepen si shtesë! (Mt 6, 31-33).

* Kisha katolike është mësuesja e fesë dhe e moralit. Ajo pareshtur mëson se marrëdhëniet bashkëshortore kanë dy dimensione që nuk mund të ndahen nga njëri-tjetri: bashkimi seksual mes burrit dhe gruas në martesë përbën një dashuri dhuruese e njësuere; dashuria bashkëshortore është e hapur ndaj jetës. Sqarime më të hollësishme do të mund të gjeni në dokumentet *Humanae Vitae* dhe *Donum Vitae*. Kështu, jo vetëm dështimi, por edhe kontrceptimi, sterilizimi dhe ngjizja artificiale, si p.sh ngjizja në provëz dhe mbjellja e farës janë kundër jetës, janë mëkate të rënda. Shumë pak prej fëmijëve që ngjizen në provëz jetojnë. Shumicën e tyre i mbysin apo i mbajnë të ngrirë në frigoriferë.

* Nuk lejohen procese diagnostike, si p.sh. amniocenteza e hershme, e cila ka për qëllim vrasjen e fëmijës së sëmurë. Nuk lejohet as vrasja e të sëmurve! Askush nuk ka arritur të bëhet i lumtur duke vrasur, por lumturia e vërtetë arrihet duke i shërbyer jetës. Mëkati asnjëherë nuk është zgjedhje.

* Papa Piu XI në Enciklikën *Casti conubii*, duke folur për mjetet kontrceptive dhe sterilizimin, thotë: "Në çdo martesë ku me angazhimin e njeriut në marrëdhëniet seksuale pengohet aftësia natyrore e krijimit të jetës, thyhet Urdhri i Zotit dhe ai që vepron në këtë mënyrë, në shpirt ka bërë një mëkat mortar" (56).

* Edhe ata që prodhojnë, shpërndajnë apo reklamojnë prezervativët, janë përgjegjës jo vetëm për thyerjen e Urdhrit të shtatë të Zotit "Mos kurvëro!", por edhe për dhënien e një sigurie të rrejtshme se duke i përdorur ato, nuk do të mund të përhapen sëmundjet ngjithëse.

Është konstatuar se duke përdorur prezervativët përhapet virusi i SIDA-s, Humani Papiloma, Chlamidia trachomatis, herpesi gjenital, sifilizi, hepatiti dhe shumë sëmundje të tjera. Komisioni Papnor për familje, në dokumentin "Seksualiteti njerëzor: e vërteta dhe domethënia", na porositi: "Në këtë kontekst, prindërit duhet të shmangin përhapjen e të ashtuquajturit 'seks të sigurt', pasi është një politikë e rrezikshme dhe jo natyrore, e cila bazohet në teorinë se prezervativi mund të mbrojë nga SIDA".

* Nëse nuk dëshirojmë të kemi një fëmijë, atëherë duhet të jemi të përmbajtur në ditët pjellore të ciklit të gruas. Koha pjellore dhe ajo jopjellore mund të dallohet thjesht dhe me një saktësi të madhe, madje edhe në rastet kur gruaja ka një cikël të çrregullt. Një gjë e tillë është e mundur me anë të metodës natyrore Billings apo të metodës Simpto-termike.

* Jeta seksuale nuk guxon të ushtrohet para dhe jashtë martesës së bekuar nga Zoti.

T'i lutemi Zotit që të mund të kuptojmë dhe të bëjmë çfarë është e mundur për mbrojtjen e atyre, të cilëve u rrezikohet jeta dhe të shpallim vlerat morale e dashurinë ndaj familjes e fëmijëve.

Dr. med. Antun Lisec

PRO CREDIT BANK

LLOGARIA NË EURO 127837030002

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 05209111240000127837030002

LLOGARIA NË LEK 127837030101

Kodi SWIFT: FEFAALFR

IBAN: AL 48209111240000127837030101

INTESA SAN PAOLO BANK

LLOGARIA NË EURO 1043631803

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 25208110080000001043631803

LLOGARIA NË LEK 1043631801

Kodi SWIFT: USALALTR

IBAN: AL 79208110080000001043631801

NË ZVICËR ME 5 FRANGA

Duke telefonuar në numrin:

0900123411

Në bankën CREDIT SUISSE

RADIO MARIA

LLOGARIA NË CHF 361173-10-1

IBAN: CH1804835036117310001